

V E N D I M
Nr.323, datë 8.7.1999

**PËR PËRGATITJEN, PËRSHTATJEN DHE ZBATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE
DHE PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT ME RREGULLAT
TEKNIKE DHE STANDARDET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dispozitave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:
 - përgatitjen, përshtatjen dhe zbatimin e rregullave teknike;
 - procedurat për vlerësimin e konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore;
 - njohjen e vlerësimit të konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore;
 - procedurat për vlerësimin e konformitetit nga organizmat joshtetërorë;
 - sistemet ndërkombëtare dhe rajonale të vlerësimit të konformitetit.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, sipas fushave të veprimtarisë që mbulojnë, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

PËRGATITJA, ADOPTIMI DHE ZBATIMI I RREGULLAVE TEKNIKE

1. Terminologjia e përdorur:
 - 1.1- Procedura e vlerësimit të konformitetit – Quhet çdo procedurë direkt ose indirekt, për të përcaktuar nëse kërkesat e dhëna në një rregull teknik ose standard, janë plotësuar.
 - 1.2- Procedurat e vlerësimit të konformitetit përfshijnë procedurat për marrjen e mostrave, provat/analizat dhe inspektimet; vlerësimin, verifikimin dhe sigurimin e përputhjes; regjistrimin, akreditimin dhe aprovimin, si dhe kombinimet e tyre.
 - 1.3- Organe joshtetërore – Kuptohen ato organe private të vlerësimit të konformitetit të cilave shteti iu jep të drejtën për të kryer procedurat e vlerësimit të konformitetit.
 - 1.4- OBT - kuptohet Organizata Botërore e Tregtisë
2. Përsa u përket rregullave teknike, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që produkteve të importuara nga territori i çdo vendi anëtar i OBT-së, t'u jepet një trajtim jo më pak i favorshëm nga ai që u jepet produkteve të ngjashme me origjinë kombëtare, si dhe produkteve të ngjashme me origjinë nga vendet e tjera.
3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që rregullat teknike të mos përgatiten, adoptohen ose zbatohen me qëllimin, ose me pasojën, e krijimit të pengesave të panevojshme në tregtinë ndërkombëtare. Për këtë qëllim, rregullat teknike nuk duhet të jenë shumë më kufizuese ndaj tregtisë, nga ç'është e nevojshme. Një gjë e tillë bëhet për të përmbushur një objektiv të ligjshëm duke patur parasysh rreziqet që do të krijoheshin nga mospërmbushja e tij. Objektiva të tillë të ligjshëm, ndër të tjera, janë: kërkesat për sigurinë kombëtare, parandalimi i praktikave mashtruese, mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë së njeriut, mbrojtja e jetës ose e shëndetit të kafshëve apo të bimëve dhe ajo e mjedisit. Në vlerësimin e rreziqeve të tilla, elemente të rëndësishme për t'u patur parasysh, ndër të tjera, janë: informacioni

i dobishëm shkencor e teknik, teknologjia përpunuese që lidhet me produktet apo destinacioni i parashikuar i përdorimit të tyre.

4. Rregullat teknike nuk mbahen në fuqi nëse rrethanat apo objektivat që e kanë bërë të nevojshëm miratimin e tyre nuk ekzistojnë më, ose nëse rrethanat apo objektivat e ndryshuar mund të trajtohen sipas një mënyre që është më pak kufizuese për tregtinë.

5. Në rastet kur kërkohen rregulla teknike dhe standardet ndërkombëtare përkatëse ose ekzistojnë ose përfundimi i tyre është i afërt, si bazë për rregullat e tyre teknike, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa të përdorin ose ato ose pjesë të rëndësishme të tyre, me përjashtim kur standarde të tilla ndërkombëtare ose pjesë të rëndësishme të tyre do të ishin të paefektshme ose të papërshtatshme për përmbushjen e objektiveve të ligjshëm, siç janë faktorët themelorë klimaterikë ose gjeografikë, ose për shkak të problemeve themelore teknologjike.

6. Ministria ose institucioni qendror që përgatit, miraton ose zbaton një rregull teknik, që mund të ketë një efekt të ndjeshëm në tregtinë me vendet e anëtare të OBT-së, me kërkesën e një anëtari tjetër dhe në bazë të dispozitave të paragrafëve nga 2 deri në 5, duhet të shpjegojë përligjen e atij rregulli teknik. Kur përgatitet, miratohet ose zbatohet një rregull teknik për një nga objektivat e ligjshëm të përmendur qartë në paragrafin 3 dhe kur ai është në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, rregulli teknik duhet të lerë të kuptojë pa ekuivoke se nuk krijon asnjë pengesë të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare.

7. Duke patur parasysh harmonizimin e rregullave teknike mbi një bazë sa më të gjerë që të jetë e mundur, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të aktivizohen plotësisht, brenda mundësive të tyre, në përgatitjen e standardeve ndërkombëtare nga organet përkatëse ndërkombëtare të standardizimit, standarde që kanë të bëjnë me produktet për të cilat ata ose kanë miratuar, ose presin të miratojnë rregulla teknike.

8. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa për të shqyrtuar mundësinë e pranimit të rregullave teknike të vendeve anëtare të OBT-së si rregulla të barasvlershme, edhe sikur këto rregulla të ndryshojnë nga ato të tyre, por me kusht që të jenë të bindur se këto rregulla i përmbushin në mënyrë të mjaftueshme objektivat që synojnë të arrijnë me hartimin e rregullave nga ana e tyre.

9. Kur gjykohet e nevojshme, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa për të specifikuar rregullat teknike që mbështeten te kërkesat e produktit në lidhje me funksionimin e tij dhe jo me anën përshkrimore dhe vizatimore të tij.

10. Kur nuk ekziston ndonjë standard përkatës ndërkombëtar, ose kur përmbajtja e një rregulli teknik të propozuar nuk është në përputhje me përmbajtjen teknike të standardeve përkatëse ndërkombëtare, si dhe kur ekzistojnë gjasat që rregulli teknik të ushtrojë një efekt të ndjeshëm në tregtinë e vendeve të tjera anëtare, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që:

10.1 të bëjë njoftim në buletin duke lënë një kohë të mjaftueshme, në mënyrë që palët e interesuara në vendet e tjera anëtare të OBT-së, të kenë mundësi të njihen me projektin dhe të dinë se po propozohet futja në përdorim e një rregull teknik të veçantë;

10.2 të njoftojnë nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, anëtarët e tjerë të OBT-së se për produktet që do të mbulohen nga rregulli teknik i propozuar, duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe bazën ku mbështetet rregulli teknik. Këto njoftime duhet të bëhen duke lënë një kohë të mjaftueshme brenda së cilës mund të bëhen rregullime dhe vërejtjet të mund të merren parasysh;

10.3 sipas kërkesës, ministritë dhe institucionet qendrore, duhet të venë në dispozicion hollësi rreth rregullit teknik të propozuar ose kopje të tij dhe, kur është e mundur, të identifikohen pjesët që shmangen ndjeshëm nga standardet ndërkombëtare përkatëse;

10.4 ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, u lihet një kohë e arsyeshme për të bërë vërejtje me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje, nëse një gjë e tillë u kërkohet nga vendet e tjera anëtare të OBT-së, si këto vërejtje me shkrim ashtu edhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

11. Në rastet kur linden ose ka rrezik të linden probleme urgjente për sigurinë, shëndetin, mbrojtjen e mjedisit apo sigurinë kombëtare, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, mund t'i kapërcejnë disa nga hapat e renditur në paragrafin 10, si ta gjykojnë vetë të arsyeshme, me kusht që me miratimin e një rregulli ato:

11.1 do të njoftojnë menjëherë nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, anëtarët e tjerë të OBT-së për rregullin teknik të veçantë dhe për produktet që mbulohen prej tij, duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe për bazën ku mbështetet rregulli teknik, përfshirë edhe natyrën e problemeve urgjente që lidhen me të;

11.2 sipas kërkesës, anëtarëve të OBT-së duhet t'u vihen në dispozicion kopje të rregullave teknike;

11.3 anëtarëve të tjerë të OBT-së pa dallim, duhet t'u lihet një kohë e arsyeshme për t'i paraqitur vërejtjet e tyre me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje, nëse një gjë e tillë kërkohet; nga ana tjetër, vërejtjet me shkrim, si dhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

12. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa, që të gjitha rregullat teknike që miratohen ose të botohen menjëherë, ose të bëhen të disponueshme në ndonjë mënyrë tjetër për t'u mundësuar palëve të interesuara në vendet e tjera anëtare të OBT-së të njihen me to.

13. Me përjashtim të rrethanave urgjente që përmenden në paragrafin 11, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të lënë një interval të arsyeshëm kohe midis botimit të rregullave teknike dhe hyrjes së tyre në fuqi, në mënyrë që t'u jepet kohë prodhuesve të vendeve anëtare eksportuese të OBT-së dhe veçanërisht atyre të vendeve anëtare të OBT-së që konsiderohen vende në zhvillim për t'ua përshtatur produktet e tyre ose metodat e tyre të prodhimit, kërkesave të vendit anëtar të OBT-së, importues.

PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT NGA MINISTRITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE

14. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa që në rastet kur kërkohet një sigurim i duhur konformiteti qoftë me rregullat teknike, qoftë me standardet, ato të zbatojnë dispozitat për produktet me origjinë nga territori i anëtarëve të tjerë, të cilat jepen si më poshtë:

14.1 procedurat e vlerësimit të konformitetit përgatiten, miratohen e zbatohen në atë mënyrë që t'u jepet mundësi hyrjeje furnizuesve të produkteve të ngjashme me origjinë nga territori i vendeve anëtarë të OBT-së, në kushte jo më pak të favorshme se ato që u janë akorduar furnizuesve të produkteve të ngjashme me origjinë kombëtare ose me origjinë nga çdo vend tjetër, në një situatë të ngjashme;

Hyrja nënkupton të drejtën e furnizuesve për vlerësimin e konformitetit në bazë të rregullave të procedurës, përfshirë, kur parashikohet nga kjo procedurë, edhe mundësinë për të zhvilluar aktivitete për vlerësimin e konformitetit në qendrën ku janë impiantet e prodhimit, si dhe mundësinë për të marrë markën e sistemit;

14.2 procedurat për vlerësimin e konformitetit nuk mund të përgatiten, të miratohen ose të zbatohen me qëllim që të krijojnë pengesa të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare. Kjo do të thotë se procedurat e vlerësimit të konformitetit nuk do të jenë më të rrepta, ose nuk do të zbatohen me një rreptësi më të madhe, nga ç'është e nevojshme për t'i dhënë një vendi anëtar importues besimin e mjaftueshëm se produktet janë në konformitet me rregullat ose standardet teknike të zbatueshme, duke mbajtur parasysh rreziqet që do të krijoheshin nga moskonformiteti.

15. Gjatë zbatimit të dispozitave të paragrafit 14, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që:

15.1 procedurat e vlerësimit të konformitetit duhet të fillohen e të përfundohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo sipas një rendi, i cili, për produktet me origjinë nga territoret e vendeve anëtare të OBT-së, të jetë më pak i favorshëm në krahasim me produktet e ngjashme kombëtare;

15.2 periudha normale e përpunimit të çdo procedure për vlerësimin e konformitetit botohet ose i bëhet e njohur subjektit që e kërkon. Kur organi kompetent merr një kërkesë, ai shqyrton menjëherë shkallën e plotësisë së dokumentacionit dhe e njofton subjektin kërkuar, në mënyrë të saktë e të plotë për të gjitha mangësitë. Organi kompetent i përcjell subjektin kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur rezultatet e vlerësimit në një mënyrë të saktë e të plotë, me qëllim që të bëhen ndreqjet e duhura nëse është e nevojshme, por edhe kur kërkesa ka mangësi, organi kompetent vazhdon, për aq sa mund të jetë e realizueshme me vlerësimin e konformitetit nëse subjekti e kërkon këtë; dhe po me kërkesë, subjekti njoftohet për statin e procedurës, duke marrë shpjegime edhe për ndonjë vonesë;

15.3 kërkesat për informacion janë të kufizuara për aq sa është e nevojshme për të vlerësuar konformitetin dhe për të caktuar tarifat;

15.4 fshehtësia e informacionit për produktet me origjinë nga territoret e vendeve anëtare të OBT-së, informacion i cili ose përftohet nga procedurat e vlerësimit të konformitetit ose bashkëshoqërohet me to, respektohet në të njëjtën mënyrë që respektohen edhe produktet e vendit dhe me qëllim që të mbrohen interesat e ligjshme tregtare;

15.5 çdo tarifë pagese që caktohet për vlerësimin e konformitetit të produkteve me origjinë nga territoret e vendeve anëtare të OBT-së, duhet të jenë e barabartë me çdo tarifë pagese për vlerësimin e konformitetit të produkteve të ngjashme me origjinë kombëtare ose me origjinë nga çdo vend tjetër, duke patur parasysh komunikimin, transportin dhe kostot e tjera që shkaktohen nga vendndodhja e prodhuesit dhe e organit të vlerësimit të konformitetit;

15.6 vendndodhjet e aparaturave që përdoren në procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe përzgjedhja e kampioneve nuk duhet të jenë të tilla që t'u shkaktojnë pengesa të panevojshme subjekteve ose përfaqësuesve të tyre;

15.7 kur specifikimet e produktit ndryshojnë si rrjedhim i përcaktimit të konformitetit të tij me rregullat teknike ose me standardet e zbatueshme, procedura e vlerësimit të konformitetit për produktin e modifikuar kufizohet në atë që është e nevojshme për të përcaktuar nëse ekziston besimi i mjaftueshëm se produkti vazhdon t'i përmbushë rregullat teknike ose standardet;

15.8 ekziston një procedurë për të shqyrtuar ankesat që kanë të bëjnë me ndjekjen e një procedure për përcaktimin e konformitetit dhe për të marrë masat korrigjuese kur një ankesë është e përligjur.

16. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore kryejnë kontrolle të arsyeshme në vendin e prodhimit brenda territoreve të Republikës së Shqipërisë sipas fushave që ato mbulojnë.

17. Në rastet kur kërkohet një siguri e mjaftueshme se produktet janë në konformitet me rregullat teknike ose me standardet dhe kur udhëzimet ose rekomandimet e duhura të nxjerra nga organet ndërkombëtare të standardizimit ose ekzistojnë, ose përfundimi i tyre është i afërt, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore duhet të marrin masa që t'i përdorin ato si bazë për procedurat e tyre të vlerësimit të konformitetit, me përjashtim kur si rregull kërkohet të shpjegohet se udhëzime apo rekomandime të tilla, ose pjesë të rëndësishme të tyre, janë të papërshtatshme për vendet e anëtare në OBT-së për arsye të tilla si: siguria kombëtare, parandalimi i praktikave mashtruese; mbrojtja e shëndetit ose e sigurisë së njeriut; mbrojtja e jetës ose shëndetit të kafshëve e të bimëve ose mbrojtja e mjedisit; faktorët klimaterikë ose faktorë të ndryshëm gjeografikë; probleme themelore teknologjike ose të infrastrukturës.

18. Duke patur si synim harmonizimin e procedurave të vlerësimit të konformitetit mbi një bazë sa më të gjerë që të jetë e mundur, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore aktivizohen brenda mundësive të tyre, në përgatitjen nga organet ndërkombëtare të standardizimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve për procedurat e vlerësimit të konformitetit.

19. Kur një udhëzim ose rekomandim i nxjerrë nga një organ ndërkombëtar standardizimi nuk ekziston, ose kur përmbajtja teknike e një procedure të propozuar për vlerësimin e konformitetit nuk është në përputhje me udhëzimet dhe me rekomandimet e nxjerra nga organet ndërkombëtare të standardizimit, si dhe në rastet kur procedura e vlerësimit të konformitetit ka gjasa të ushtrojë një efekt të ndjeshëm në tregtinë e vendeve të tjera, ministrinë dhe institucionet e

tjera qendrore:

19.1 duhet të botojnë një njoftim në buletin në një kohë përshtatshme në mënyrë që t'u japin mundësi palëve të interesuara të njihen me të, pra të njoftojnë se propozojnë të vënë në përdorim një procedurë të veçantë për vlerësimin e konformitetit;

19.2 të njoftojnë, nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, vendet e tjera anëtare për produktet që do të mbulohen nga procedura e propozuar për vlerësimin e konformitetit duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe bazën ku mbështetet ajo. Një njoftim i tillë duhet të bëhet duke lënë një afat kohor të përshtatshëm në të cilin mund të bëhen amendime dhe kur mund të merren parasysh vërejtjet;

19.3 sipas kërkesës, të interesuarve duhet t'u vihen në dispozicion hollësi ose kopje të procedurës së propozuar dhe, kur është e mundur, të identifikohen pjesët që shmangen ndjeshëm nga udhëzimet ose rekomandimet përkatëse të nxjerra nga organet ndërkombëtare të standardizimit;

19.4 t'u lejojnë një afat kohor të arsyeshëm dhe pa dallim vendeve të tjera anëtare të OBT-së , për të bërë vërejtje me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje dhe nëse një gjë e tillë kërkohet, si vërejtjet me shkrim ashtu edhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

20. Në rastet kur lindin ose ka rrezik të lindin probleme urgjente për sigurinë, shëndetin, mbrojtjen mjedisore ose sigurinë kombëtare, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore mund t'i kapërcejnë disa nga hapat e renditur në paragrafin 19 me kusht që me miratimin e një procedure të tillë këto organe:

20.1 të njoftojnë menjëherë nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, vendet e tjera anëtare të OBT-së për procedurën e veçantë dhe për produktet që mbulohen prej saj, duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe për bazën ku mbështetet procedura, përfshirë dhe natyrën e problemeve urgjente;

20.2 sipas kërkesës së vendeve anëtare të OBT-së, atyre u vihen në dispozicion kopje të rregullave të procedurës;

20.3 t'u lënë një kohë të arsyeshme dhe pa dallim vendeve anëtare të tjera të OBT-së për të bërë vërejtje me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje, nëse një gjë e tillë u kërkohet; si këto vërejtje me shkrim, ashtu edhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

21. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që të gjitha procedurat e vlerësimit të konformitetit që miratohen, ose të botohen menjëherë ose të bëhen të disponueshme në ndonjë mënyrë tjetër për t'u mundësuar palëve të interesuara në vendet e tjera anëtare të OBT-së njohjen me to.

22. Me përjashtim të rrethanave urgjente, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa për të lënë një interval të arsyeshëm kohe midis botimit të kërkesave qoftë në lidhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, qoftë me hyrjen e tyre në fuqi, në mënyrë që t'u jepet kohë prodhuesve të vendeve anëtare eksportuese të OBT-së , veçanërisht atyre të vendeve në zhvillim, për t'ua përshtatur produktet e tyre, ose metodat e tyre të prodhimit, kërkesave të vendit anëtar importues.

NJOHJA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NGA MINISTRITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QËNDRORE

23. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa kur është e mundur që rezultatet e procedurave të vlerësimit të konformitetit në vendet e tjera anëtare të OBT-së , të pranohen edhe kur këto procedura ndryshojnë nga ato të tyre, me kusht që ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të jenë të bindura se këto procedura ofrojnë një sigurim konformiteti me rregullat ose standardet teknike të zbatueshme që janë të barasvlershme me procedurat e tyre. Për këtë është e nevojshme të bëhen konsultime paraprake për të arritur në një mirëkuptim

reciprok, sidomos në lidhje me:

23.1 një nivel kompetence teknike të mjaftueshme e të qëndrueshme nga ana e organeve të caktuara të vlerësimit të konformitetit në vendin anëtar eksportues të OBT-së në mënyrë që të krijohet besimi në mënyrën e kryerjes së procedurës të vlerësimit të konformitetit nga ana e tyre; në këtë aspekt, si tregues i kompetencës së mjaftueshme teknike do të konsiderohet konformiteti i verifikueshëm, nëpërmjet akreditimit, me udhëzimet ose rekomandimet e nxjerra nga organet ndërkombëtare të standardizimit;

23.2 kufizimet e pranimi të rezultateve të vlerësimit të konformitetit për ato produkte që janë prodhuar nga organet e caktuara në vendin anëtar eksportues të OBT-së .

24. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa me anë të procedurave të tyre të vlerësimit të konformitetit për zbatimin e dispozitave të paragrafit 23.

25. Nëse kërkohet nga anëtarët e tjerë të OBT-së , ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që të jenë të gatshme të hyjnë në negociata për arritjen e marrëveshjeve për njohjen e ndërsjelltë të rezultateve të procedurave të vlerësimit të konformitetit të njëri-tjetrit. Vendet anëtare të OBT-së mund të kërkojnë që marrëveshje të tilla të përmbushin kriteret e paragrafit 23, si dhe të përmbajnë avantazhe të ndërsjellta në lidhje me mundësitë e tyre për të lehtësuar tregtinë në fushën e produkteve në fjalë.

26. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që t'i lejojnë organet e vlerësimit të konformitetit që ndodhen në territoret e vendeve të tjera anëtarëve të OBT-së të marrin pjesë në procedurat e tyre të vlerësimit të konformitetit në bazë të kushteve jo më pak të favorshme se ato që u akordohen organeve që ndodhen brenda territoreve të tyre ose territoreve të çdo vendi tjetër.

PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT NGA ORGANET JO SHTETRORE

27. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që organet joshtetërore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të cilat punojnë me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të respektojnë dispozitat e paragrafit 14, me përjashtim të detyrimit për të njoftuar procedurat e propozuara të vlerësimit të konformitetit. Përveç kësaj ministritë dhe institucionet e tjera qendrore nuk duhet të marrin masa të cilat do t'i detyronin këto organe që të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e paragrafëve 14 deri 26.

28. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të mbështeten te procedurat e vlerësimit të konformitetit me të cilat punojnë organet joshtetërore, por duke mbajtur parasysh që këto organe të jenë në pajtim me dispozitat e paragrafëve 14 deri 26 me përjashtim të detyrimit për të njoftuar procedurat e propozuara të vlerësimit të konformitetit.

SISTEMET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

29. Në rast se kërkohet që konformiteti me një rregull teknik ose me një standard ndërkombëtar të jetë i besueshëm për kërkuesin dhe në rast se kjo është e realizueshme, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore duhet të formulojnë e të adoptojnë sisteme ndërkombëtare për vlerësimin e konformitetit, të bëhen anëtarë të tyre ose të marrin pjesë në to.

30. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që sistemet ndërkombëtare dhe rajonale për vlerësimin e konformitetit në të cilat janë ose anëtarë ose pjesëmarrës, të jenë në pajtim me dispozitat e paragrafëve 14 dhe 15. Ato nuk duhet të veprojnë në mënyrë të tillë që të ndikojnë direkt ose indirekt mbi organet e standardizimit për t'u kërkuar ose për t'i nxitur ato, që të veprojnë në një mënyrë që nuk përputhet me dispozitat e paragrafëve 14 deri 26.

31. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, mbështeten në sistemet ndërkombëtare ose rajonale të vlerësimit të konformitetit, deri në atë masë sa këto sisteme janë në pajtim me paragrafët 14 deri 26.

